

VENDIM
Nr. 80/2026

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS SË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar; si dhe të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 33/2022, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)” shfuqizohet.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 8.5.2026.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERRU

Lidhja nr.1



**ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA (ERRU)**

Lidhja nr.2

KOMISIONI I ERRU-SË	Kategoria e pagës		Numri
	Sipas Vendimit 33/2022	Sipas VKM 325/2023	
KRYETARI			1
ANËTARË KOMISIONI			4
Këshilltar i Komisionit		1-4	1
Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit			1
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-b	1-2	1
DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE			9
Drejtor drejtorie	II-b	II-1	1
<i>Sektori Teknik dhe Licencave</i>			
Përgjegjës sektori	III-a	III-1	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësjellësve dhe ITUP	III-b	IV-1	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUZ dhe ITUN	III-b	IV-1	1
<i>Sektori Ekonomik dhe Tarifave</i>			
Përgjegjës sektori	III-a	III-1	1
Specialist i analizës ekonomiko - financiare	III-b	IV-1	1
Specialist i analizës së aseteve dhe investimeve	III-b	IV-1	1
<i>Sektori i Monitorimit dhe Performancës</i>			
Specialist i performancës operative dhe cilësisë shërbimit	III-b	IV-1	1
Specialist i performancës ekonomiko – financiare	III-b	IV-1	1
DREJTORIA JURIDIKE DHE KONSUMATORIT			6
Drejtor drejtorie	II-b	II-1	1
<i>Sektori Juridik</i>			
Përgjegjës sektori	III-a	III-1	1
Specialist ligjor	III-b	IV-1	2
<i>Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorin</i>			
Specialist i trajtimit të ankesave	III-b	IV-1	1
Specialist i marrëdhënieve me publikun	III-b	IV-1	1

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE			<u>9</u>
Drejtor drejtorie	II-b	II-1	1
<i>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Financiare</i>			
Përgjegjës sektori	III-a	III-1	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	IV-1	1
Specialist finance	III-b	IV-1	1
<i>Sektori i Shërbimeve</i>			
Specialist IT	III-b	IV-1	1
Specialist protokoll – arkiv	IV-b	IV-3	1
<i>Punonjës mbështetës</i>			
Shoferë			2
Magazinjër dhe sanitare			1
TOTALI			32